



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 29

Tiranë – E mërkurë, 22 shkurt 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 1, datë 9.2.2017	Për disa ndryshime në vendimin nr. 44, datë 19.9.2016, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, i ndryshuar..... 1983
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 3, datë 9.2.2017	Për drejtimet prioritare të politikës dhe kalendarin e programeve të financimit të Fondit të Zhvillimit të Rajoneve, për vitin 2017..... 1989
Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 8, datë 13.2.2017	Për shpërndarjen e financimit për projekte, thirrja e katërt për vitin 2016, të grantit “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale, shtylla I..... 1992
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 30, datë 7.2.2017	Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të funksionarit publik, anëtar në Këshillin e Bashkisë Elbasan, z. Gani Hida, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”..... 1997
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 35, datë 7.2.2017	Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të funksionarit publik, anëtar në Këshillin e Bashkisë Maliq, z. Tomor Prenjasi, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”..... 1999



VENDIM
Nr. 1, datë 9.2.2017

PËR DISA NDRYSHIME NË
VENDIMIN NR. 44, DATË 19.9.2016, TË
KOMITETIT PËR ZHVILLIMIN E
RAJONEVE, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 16 dhe të aneksit 3, të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Në tabelën nr.1, që i bashkëlidhet vendimit nr. 51, datë 5.12.2016, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për disa ndryshime në vendimin e Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 44, datë 19.9.2016”, bëhen ndryshimet, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Zhvillimit Urban dhe ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETAR
Niko Peleshi

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar;
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar;



Tabela 1, e vendimit nr. 51, datë 5.2.2016, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për disa ndryshime në vendimin e Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 44, datë 19.9.2016”, zëvendësohet me tabelën, si më poshtë vijon:

Tabela 1 Lista e projekteve me cikël financimi 2016-2017, “Granti, infrastruktura vendore dhe rajonale”, “Programi i zhvillimit vendor dhe rajonal, shtylla I, financimi për vitin 2017

Njësia e Qeverisjes Vendore	Emërtimi i Objektivit	Nr. i vendimit të KZHR	Vlera e plotë e projektit (në Lekë)	Vlera e Kontratës (në Lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016	Veprimi korrektues për vitin 2016
Qarku Berat						
Bashkia Polican	Rehabilitimi i shëtitores Miqësia	nr.10, datë, 10.03.2016	27 546 411	27 488 376	13 715 171	58 035
Bashkia Skrapar	Rikualifikimi i hapësirave përreth Pallatit të Kulturës, rruga me trafik të kufizuar/pedonalja "Pasha Hysi", rruga automobilistike "Pasha Hysi"	nr.10, datë, 10.03.2016	265 427 536	264 704 108	131 990 340	723 428
Bashkia Ura Vajgurore	Rehabilitimi urban i zonës përgjatë lumit Osum, loti 1	nr.10, datë, 10.3.2016	179 989 500	131 908 092	41 913 342	48 081 408
Qarku Dibër						
Bashkia Diber	Rinovim i infrastrukturës së bulevardit "Elez isufi", rrugës "Safet Zhulali" dhe rrugës së "Muzeut"	nr.10, datë, 10.3.2016	110 726 698	104 789 063	49 425 714	5 937 635
Bashkia Diber	Përmirësimi i infrastrukturës vendore dhe rivitalizim i hapësirave publike në zonën pranë Pallatit të Kulturës	nr.10, datë, 10.3.2016	207 649 090	207 506 697	103 682 152	142 393
Qarku Durrës						
Bashkia Shijak	Rikualifikim i sheshit tek lagjja "Lugina"	nr.31, datë, 13.6.2016	25 202 594	25 093 368	12 492 071	109 226



Bashkia Kruje	Zgjerim i rrugës hyrëse të qytetit, parkimi dhe rikualifikimi i qendrës së qytetit	nr.10, datë 10.3.2016	366 281 871	364 453 272	181 312 337	1 828 599
Qarku Elbasan						
Bashkia Belsh	Projekti i Ansamblit Rilindja, Belsh	nr.10, datë, 10.3.2016	180 801 690	179 957 360	89 556 515	844 330
Bashkia Elbasan	Rikonstruksion i rrugës rurale Qaf Hajdaran - Byshek	nr.10, datë, 10.3.2016	183 168 845	181 222 161	89 637 739	1 946 684
Bashkia Elbasan	Sistemim - Asfaltim i rrugës "28 Nëntori"	nr.10, datë, 10.3.2016	194 988 741	190 995 623	93 501 253	3 993 118
Bashkia Peqin	Ura e fshatit Grykesh, te Njësia Administrative Pajove, Bashkia Peqin	nr.10, datë, 10.3.2016	3 840 680	3 571 337	1 650 997	269 343
Qarku Fier						
Bashkia Divjakë	Segmenti 3 i Pasarelës+Ure në dru përgjatë rrugës automobilistike, Hyrje e Parkut-Godulla e Brendshme	nr.10, datë, 10.3.2016	102 130 235	99 495 414	48 430 297	2 634 821
Bashkia Fier	Ndërtim i parkut qendror të qytetit, rehabilitim i rrugës "Xoxi Andoni" dhe hapësirat rreth saj	nr.10, datë, 10.3.2016	300 126 792	298 786 258	148 722 862	1 340 534
Bashkia Fier	Rivitalizim i parkut pranë bar Rinisë dhe rehabilitim i rrugës Dervish Hekali	nr.10, datë, 10.3.2016	147 498 882	143 730 840	69 981 399	3 768 042
Bashkia Lushnjë	Rotondo e Plugut-Postoblllok, rruga e hyrjes Lushnjë-Tiranë, (faza e dytë)	nr.10, datë, 10.3.2016	106 224 781	102 989 042	49 876 652	3 235 739
Bashkia Patos	Shëtitore "Republika"	nr.10, datë, 10.3.2016	98 615 048	96 285 666	46 978 142	2 329 382
Bashkia Patos	Ndërtimi i rrugës Ruzhdie - Gjinoqar	nr.10, datë, 10.3.2016	66 213 456	37 003 000	3 896 272	29 210 456



Bashkia Roskovec	Projekt zhvillimor për fshatin Kuman	nr.31, datë, 13.6.2016	30 548 315	28 800 000	13 525 843	1 748 315
Bashkia Roskovec	Sistemim - asfaltim i rrugës së fshatit Kurjan	nr.31, datë, 13.6.2016	148 286 386	143 835 891	69 692 698	4 450 496
Qarku Gjirokastrë						
Bashkia Gjirokastrë	Rikonstruksion i hapësirave publike dhe rrugës hyrëse pranë Memorialit të Rilindasve në Gjirokastrë	nr.10, datë, 10.3.2016	99 755 007	58 220 247	8 342 744	41 534 760
Bashkia Këlcyre	Rikualifikim urban përreth përroit në lagjen "Gur" si edhe sistemim i shtratit të përroit	nr.10, datë, 10.3.2016	67 810 604	67 757 108	33 851 806	53 496
Bashkia Memaliaj	Projekti i Ansamblit Arkitektonik të sheshit Minatori, Memaliaj	nr.10, datë, 10.03.2016	151,350,288	98,683,679	23,008,535	52,666,609
Bashkia Tepelene	Hyrja "Ali Pasha", vazhdimi i shëtitores përgjate kalasë	nr.31, datë, 13.6.2016	149 984 392	147 599 953	72 607 757	2 384 439
Qarku Korçë						
Bashkia Devoll	Rikualifikim urban i qendrës së qytetit Bilisht, loti 1	nr.10, datë, 10.3.2016	124 315 222	123 043 330	60 885 719	1 271 892
Bashkia Kolonje	Rikonstruksioni i rrugëve dhe fasadave të sheshit "Rilindja", Ersekë	nr.10, datë, 10.3.2016	51 858 597	51 132 805	25 203 507	725 792
Bashkia Korce	Restaurimi i objekteve të pazarit Korçë, loti 2	nr.10, datë, 10.3.2016	167 166 000	162 438 077	78 855 077	4 727 923
Bashkia Korçë	Rikonstruksion i qendrës dhe infrastrukturës rrugore dhe monumenteve të kulturës, Voskopoje	nr.10, datë, 10.3.2016	370 000 000	362 983 320	177 983 320	7 016 680



Bashkia Korçë	Rikualifikim urban i zonës përreth qytezës së fëmijëve Korçë	nr.31, datë, 13.6.2016	396 195 200	368 063 408	169 965 808	28 131 792
Bashkia Maliq	Rehabilitim rruga hyrëse " Pylli i Fazanëve"	nr.10, datë, 10.3.2016	28 071 408	17 296 554	3 260 840	10 774 864
Qarku Kukës						
Bashkia Has	Rehabilitimi i godinave, shesheve dhe qendrës së qytetit Krumë-Has	nr.10, datë, 10.3.2016	106 997 427	103 390 324	49 891 611	3 607 103
Bashkia Tropojë	Shëtitorja e qytetit Bajram Curri/	nr.31, datë, 13.6.2016	149 270 311	114 949 590	40 314 435	34 320 721
Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Rikonstruksioni i rrugës Bajram Curri - Vernicë	nr.10, datë, 10.3.2016	65 376 393	41 873 880	9 185 684	23 502 513
Qarku Lezhë						
Bashkia Lezhë	Lulishte dhe parkimi përballë gjimnazit "Hydajet Lezha", lagjja "Besëlidhja"	nr.10, datë, 10.3.2016	25 200 932	21 924 252	9 323 786	3 276 680
Bashkia Mirdita	Rikualifikimi urban i sheshit të qytetit Rrëshen	nr.10, datë, 10.3.2016	186 901 843	172 020 124	78 569 203	14 881 719
Qarku Shkodër						
Bashkia Pukë	Sistemim i lagjes pas Pallatit të Kulturës	nr.10, datë, 10.3.2016	28 390 307	27 659 507	13 464 354	730 800
Bashkia Shkodër	Rikonstruksion i bllokut të pallateve "Xhabije"	nr.10, datë, 10.3.2016	76 654 597	46 519 616	8 192 318	30 134 981
Qarku Tiranë						
Bashkia Kavajë	Rehabilitimi i përroit Leshniqe, Kavajë	nr.10, datë, 10.3.2016	450 000 000	446 006 592	221 006 592	3 993 408
Bashkia Rrogozhinë	Rivitalizimi urban i qendrës së qytetit të Rrogozhinës	nr.31, datë, 13.6.2016	149 996 829	149 983 775	74 985 361	13 054
Bashkia Tiranë	Rikualifikimi urban i Sheshit Skënderbej, Faza I	nr.31, datë, 13.6.2016	640 084 160	633 043 125	313 001 045	7 041 035



Bashkia Vorë	Sistemim- asfaltim i rrugës lidhëse urbane Fushë Preze - Ura e Limuthit - Bërçullë - Bashkia Vorë	nr.31, datë, 13.6.2016	149 243 886	148 943 867	74 321 924	300 019
Qarku Vlorë						
Bashkia Himarë	Rikualifikim urban i sheshit Borsh	nr.10, datë, 10.3.2016	26 467 315	26 133 332	12 899 675	333 983
Bashkia Himarë	Rikualifikim urban i sheshit Lukovë	nr.10, datë, 10.03.2016	89 461 945	83 999 999	39 269 027	5 461 946
Bashkia Sarandë	Rikonceptim dhe rivitalizim i qendres së qytetit Sarandë, Rruga e Flamurit	nr.10, datë, 10.3.2016	105 643 979	102 518 468	49 696 479	3 125 511
Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Sistemim - asfaltim i rrugës së Unazës Vlorë (Poliklinka 7_Pallatet)	nr.10, datë, 10.3.2016	582 999 971	416 132 539	124 632 554	166 867 432
			7 184 464 164	6 624 933 040	3 032 700 958	559 531 135

Shënim

1. "Vlera e projektit" përfaqëson vlerën e financimit të projektit, miratuar me Vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.
2. "Vlera e kontratës" përfaqëson vlerën e kontraktuar nga autoriteti kontraktues për zbatimin e punimeve të projektit dhe korrekton vlerën e projektit. Vlera e kontratës përcillet nga sekretarati teknik (Ministria e Zhvillimit Urban).
3. "Vlera e financimit për vitin 2016" tregon vlerën e financimit të alokuar për vitin 2016, sipas vendimeve të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në vitin 2016.
4. "Veprimi korrektues për vitin 2016" është vlera që shton vlerën e financimit për vitin 2016, miratuar me vendime të mëparshme të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve. Ajo vjen nga sekretariati teknik pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban, me shkresë nr.788 prot., datë 3.2.2017.

**VENDIM****Nr. 3, datë 9.2.2017**

**PËR DREJTIMET PRIORITARE TË
POLITIKËS DHE KALENDARIN E
PROGRAMEVE TË FINANCIMIT TË
FONDIT TË ZHVILLIMIT TË
RAJONEVE, PËR VITIN 2017**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 16 dhe të aneksit 3, të ligjit nr. 130, datë 15.12.2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Miratimin e drejtimeve prioritare për vitin 2017, të politikës për programin e Zhvillimit të Infrastrukturës vendore dhe rajonale, programi “Shqipëria dixhitale” dhe programi “Mbështetje për ekonominë” të Fondit të Zhvillimit të Rajoneve, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Kalendarin e thirrjeve për financim, sipas shtyllave, programeve dhe granteve të financimit, për 6-mujorin e parë të vitit 2017 është sipas tabelës 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Ngarkohen ministri i Zhvillimit Urban, ministri i Arsimit dhe Sportit, ministri i

Transportit dhe Infrastrukturës, ministri i Mjedisit, ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, ministri i Shëndetësisë, ministri i Kulturës, ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETAR**Niko Peleshi**

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar;
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar.



Tabela 1 Drejtimet prioritare për vitin 2017 të politikës, sipas shtyllave, programeve, granteve dhe masat për Fondin e Zhvillimit të Rajoneve.

Nr.	Drejtimet prioritare	Shtylla/programi/granti	Masat
1.	Promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm	Shtylla I - "Programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale": Granti 1 – "Infrastruktura vendore dhe rajonale" Granti 2 – "Arsim" Granti 3 – "Shëndetësi" Granti 5 – "Ujësjellës-kanalizime"	Përmirësimi i aksesit, lëvizshmërisë dhe infrastrukturës në zonat më pak të zhvilluara, si dhe në ujësjellës-kanalizime. Përmirësimi i cilësisë së strukturave arsimore, rritja e aksesit në zonat e pambuluara me shërbim. Shkolla - Qendër komunitare (terrenet sportive). Përmirësimi i cilësisë së strukturave shëndetësore, rritja e aksesit në zonat e pambuluara me shërbim. Rivitalizimi i zonave informale, sigurimi i infrastrukturës së aksesit dhe shërbimit Rritja e aksesit në shërbime, me anë të aksesit në shërbime online, përmes rritjes së mbulimit.
2.	Fuqizimi i ndërhyrjeve të nisura dhe rivitalizimi i qytetit, fshatit, poliçendrave urbane	Shtylla I - "Programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale": Granti 1 – "Infrastruktura vendore dhe rajonale" Granti 6 – "Rehabilitim mjedisor, gjelbërim dhe pyllëzim" Granti 5 – "Ujësjellës-kanalizime"	Rivitalizimi i hapësirave publike, hapësirave me tipare natyrore, zonave dhe infrastrukturës në shërbim të ekonomive lokale dhe rajonale. Rivitalizimi i poliçendrave urbane dhe qendrave lokale, rritëzimi dhe nxitja përmes bashkjetesës komunitare. Përmirësimi i aksesit, lëvizshmërisë dhe infrastrukturës së ndërlidhjes. Rehabilitimi mjedisor, gjelbërimi e gjallërimi i parqeve urbane, ndërvendore, etj. Përmirësimi i cilësisë së jetës së qytetarëve përmes zhvillimit të potencialeve.
3.	Kohezioni territorial dhe zhvillimi i balancuar rajonal	Shtylla I - "Programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale": Granti 1 – "Infrastruktura vendore dhe rajonale" Granti 2 – "Arsim" Granti 3 – "Shëndetësi" Granti 4 – "Art dhe kulturë" Granti 5 – "Ujësjellës-kanalizime" Granti 6 – "Rehabilitim mjedisor, gjelbërim dhe pyllëzim" Shtylla II: Programi "Shqipëria dixhitale": Granti "Shqipëria dixhitale"	Përmirësimi i infrastrukturës për promovimin e atraksioneve, nxitjen e ndërlidhjes rurale-urbane dhe konkurrueshmërisë (infrastrukturë rrugore me interes të veçantë zhvillimi etj.) Përmirësimi i transportit, lëvizshmërisë dhe infrastrukturës ndërlidhëse lokale, ndërvendore, rajonale dhe ndërrajonale Zhvillimi i zonave funksionale të qyteteve /fshatrave. Shërbime vendore dixhitale për qytetarët dhe biznesin, bazuar në zgjidhjet "Në një sportel", nëpërmjet platformave të integruara Pasurimi dhe gjallërimi i parqeve urbane dhe shërbimeve komunitare rural - urban ndërvendore dhe rajonale. Fuqizimi i lidhjeve fshat – qytet, ngritja e qendrave multifunksionale (si edukim -luaj-sport, etj.).



4.	Stimulimi i zonave dhe poleve potenciale, cluster të zhvillimit dhe zhvillimi i ekonomisë lokale dhe rajonale	Shtylla I - “Programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale”: Granti 1 – “Infrastruktura vendore dhe rajonale” Shtylla II: Programi “Shqipëria dixhitale”: Granti “Shqipëria dixhitale” Shtylla III – “Programi i mbështetjes për ekonominë”: Granti “Mbështetje për ekonominë”	Promovimi i rritjes të rrjetit të tregtisë, ngritjes dhe zhvillimit të zonave të përmirësuara të biznesit, si edhe stimulimi i investimeve në grupime zonash me interes agroturizëm, etj.
			Promovimi dhe fuqizimi i zonave me potencial ekonomik (investime për krijimin e vlerës së shtuar).
			Plotësimi dhe përmirësimi i infrastrukturave lidhëse në ndihmë të zhvillimit të zonave ekonomike lokale dhe rajonale me qëllim përmirësimin e rrjeteve të shpërndarjes së produkteve.
			Promovimi i ngritjes së itinerareve kulturore/turistike grupime zonash me interes turistik, bujqësor, fshatra apo të kapitalit lokal dhe rajonal etj..
			Për t’u zhvilluar sipas pikës 2.3, të aneksit 3, të ligjit të buxhetit për vitin 2017.
5.	Qytetet moderne	Shtylla II - Programi “Shqipëria dixhitale”: Granti 1. “Shqipëria dixhitale”	Platforma inovative me të dhënat e qyteteve në shërbim të qytetarëve
			Sisteme dixhitale multifunksionale për menaxhimin e infrastrukturës së qyteteve në shërbim të qytetarëve dhe sistemet për përmirësimin e administrimit vendor dhe rajonal (bashkitë etj.)
			Sisteme gjeografike dhe të informacionit për programimin dhe zhvillimin e territorit dhe menaxhimin në nivel rajonal.



Tabela 2. Kalendar i thirrjeve për financim, sipas shtyllave, programeve dhe granteve të financimit për 6-mujorin e parë të vitit 2017

Thirrja	Data	Shtylla/programi/granti
Thirrja I	Shkurt 2017	Shtylla I – “Programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale” - Granti 1: “Infrastruktura vendore dhe rajonale”
		Shtylla I - Programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale - Granti 2. “Arsimi”
		Shtylla I – “Programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale” - Granti 6: “Rehabilitimi mjedisor, gjelbërim dhe pyllëzimin”
		Shtylla II - Programi “Shqipëria dixhitale” - Granti 1. “Shqipëria dixhitale”
Thirrja 2	Mars -Prill 2017	Shtylla III - Programi “Mbështetja për ekonominë”
		Shtylla I – “Programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale” – Granti 5. “Ujësjiellës-kanalizime”
		Shtylla I – “Programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale” - Granti 1 “Infrastruktura vendore dhe rajonale”

VENDIM

Nr. 8, datë 13.2.2017

PËR SHPËRNDARJEN E FINANCIMIT PËR PROJEKTE, THIRRJA E KATËRT PËR VITIN 2016, TË GRANTIT “INFRASTRUKTURA VENDORE DHE RAJONALE”, PROGRAMI I ZHVILLIMIT TË INFRASTRUKTURËS VENDORE DHE RAJONALE, SHTYLLA I

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 16 dhe të aneksit 3, të ligjit nr. 130, datë 15.12.2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozim të Ministrisë së Zhvillimit Urban, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpërndarjen e financimit për projektet e reja të thirrjes së katërt për vitin 2016, me burim financimi buxhetin total të projekteve të reja për vitin 2017, të programit buxhetor “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban, prej 3 450 865 269 (tre miliardë e katërqind e pesëdhjetë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë e dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë, i përbërë nga:

a) fondi i papërdorur për vitin 2016, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, prej 999 677 353 (nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e treqind e pesëdhjetë e tre) lekë;

dhe

b) fondi për financimin e projekteve të reja prej 2 451 187 916 (dy miliardë e katërqind e pesëdhjetë e një milion e njëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë, nga programi buxhetor “Infrastrukturë vendore dhe Rajonale” i Ministrisë së Zhvillimit Urban, për vitin 2017.

2. Shpërndarja e financimit për projekte të reja, thirrja e katërt për vitin 2016, sipas pikës 1 të këtij vendimi, të bëhet sipas tabelës 1/1 dhe 1/2, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Të gjitha autoritetet kontraktuese, projektet e të cilave miratohen për financim sipas pikës 1 të këtij vendimi, brenda një jave nga data e publikimit të tij në Fletoren Zyrtare, duhet të paraqesin në sekretariatit teknik, pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban, kalendarin me të gjitha afatet e parashikuara për fazat e prokurimit publik dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit, si dhe të përdorimit të fondeve dhe emrin e personit përgjegjës për informimin periodik.



4. Autoritetet kontraktuese për projektet sipas pikës 2 të këtij vendimi, duhet të kryejnë procedurat e prokurimit publik dhe të lidhjes së kontratës përkatëse për zbatimin e punimeve të ndërtimit, përpara fundit të tremujorit të dytë, të vitit 2017. Për fondet e projekteve të paprokuruar sipas këtij afati, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve ka të drejtën të rishqyrtojë financimin dhe t'i rishpërndajë ato.

5. Ngarkohet sekretariati teknik, pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban, të kryejë monitorimin e ecurisë së përdorimit të fondeve, sipas kalendarit të paraqitur nga autoritetet kontraktuese, në përputhje me pikën 3 të këtij vendimi dhe të informojë Ministrinë e Financave dhe periodikisht Komitetin për Zhvillimin e Rajoneve, përmes Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

6. Ngarkohen ministri i Zhvillimit Urban dhe ministri i Financave, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYETAR
Niko Peleshi

Zëvendëskryeminstri	Zëvendëskryetar;
Ministri i Financave	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar;
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Mjedisit	anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.1	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore / Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.2	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.3	anëtar;
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr.4	anëtar.



Tabela 1/1 Lista e disa projekteve të reja, thirrja e katërt për vitin 2016, me cikël zbatimi 2017-2018.

Nr.	Autoriteti Kontraktues	Emërtimi i Projektit	Vlera e plotë e projektit (në Lekë)	Vlera e financimit për vitin 2017 (në Lekë)
QARKU LEZHË				
1	Bashkia Mirditë	Zgjatimi i unazës së qytetit Rrëshen	150,587,989	75,293,995
QARKU SHKODËR				
2	Bashkia Vau i Dejës	Rehabilitim i fasadave në Bashkinë Vau i Dejës, Qendër Vau i Dejës	49,279,345	49,279,345
QARKU DIBËR				
3	Bashkia Bulqizë	Qendra e Qytetit të Ri, sheshi para ish-Këshillit të Rrethit, Bulqizë	24,401,428	24,401,428
QARKU TIRANË				
4	Bashkia Kavajë	Rikonstruksioni i rrugës “Xhami-Golem”	25,040,768	25,040,768
5	Bashkia Tiranë	Rikualifikim urban i bllokut që kufizohet nga rruga “Elbasanit” - “Stavri Vinjaku” - “Pjeter Budi” – “Ali Visha”, NJA 2	141,426,758	70,713,379
6	Bashkia Tiranë	Rikualifikim urban i bllokut të kufizuar nga rruga “Lambi Bonati” - “Haki Stermilli” – “Musine Kokalari” dhe rikonstruksion i rrugës “Zyber Zeneli”, NJA 6	122,270,071	61,135,036
QARKU ELBASAN				
7	Bashkia Elbasan	Rehabilitimi urban i sheshit “Zaranika” dhe Bulevardi “Aqif Pasha” (segmenti nga Kryqëzimi “1 Maji - Ura e Zaranikës”) - Faza IV	134,306,533	92,581,095
8	Bashkia Belsh	Ndërtimi i pedonales, korsisë së biçikletave, Liqeni Belsh	67,975,818	33,987,909
QARKU GJIROKASTËR				
9	Bashkia Libohovë	Rikualifikimi urban i qendrës së qytetit Libohovë	139,173,239	69,586,620
QARKU KORÇË				
10	Bashkia Pogradec	Sistemim rrugësh blloku tek Stadiumi	94,687,610	47,343,805
11	Bashkia Korçë	Rehabilitimi urban ndriçim, gjelbërim, në zona të ndryshme në qytet	118,921,058	59,460,529
12	Bashkia Korçë	Rehabilitim i zonave informale (lagjia 17 dhe 18, fundi i Parkut Rinia)	60,000,000	30,000,000
13	Bashkia Kolonjë	Rikualifikimi i qendrës së qytetit Leskovik	50,559,738	50,559,738
14	Bashkia Kolonjë	Rikonstruksion i rrugës “20 Maji”, në hyrje të qytetit Ersekë	35,997,041	35,997,041
15	Bashkia Maliq	Rivitalizimi i rrugës “Pëndavinj-Pojan-Zvezdë”	78,078,456	39,039,228
QARKU BERAT				
16	Bashkia Berat	Rikonstruksion i fasadave të ndërtesave të banimit dhe stadiumit “Tomori” në bulevardin “Republika”	86,976,834	43,488,417



17	Bashkia Poliçan	Rehabilitimi i zonës pas pallateve të ish-mapos dhe rikualifikim i fasadave të pallateve	23,205,535	23,205,535
18	Bashkia Poliçan	Rikualifikim i fasadave në Shëtitoren "Miqësia" dhe Rehabilitimi i rrugës së Tregut	8,311,575	8,311,575
QARKU FIER				
19	Bashkia Mallakastër	Rikualifikimi urban i lagjes "28 Nëntori" i qytetit Ballsh, Mallakastër	93,424,178	46,712,089
20	Bashkia Fier	Rehabilitimi i fasadave dhe rikonstruksioni i rrugës "Rauf Nallbani", si dhe rijetëzimi i hapësirës së terminalit të autobusave	143,041,147	71,520,574
QARKU VLORE				
21	Bashkia Finiq	Rikualifikimi urban i sheshit Livadhja	42,019,247	42,019,247
TOTALI			1,689,684,368	999,677,353

Shënim:

1. "Vlera e projektit", përfaqëson vlerën e financimit për projektin, miratuar me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.
2. "Vlera e financimit për vitin 2017 (Tabela 1/1)", është financimi me burim fondin e papërdorur në vitin 2016, Granti "Infrastruktura vendore dhe rajonale", dhe i trashëguar për përdorim në vitin 2017. Konfirmimi nga Ministria e Financave është me shkresën nr. 403/22, Prot., dt 1.2.2017, dhe komunikuar nga sekretariati teknik pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban, me shkresë nr.846, Prot., dt.7.2.2017.
3. Likuidimi financiar për vlerën e projektit (ose për vlerën e kontratës pas prokurimit publik) në vitet në vazhdim do të kryhet nga Ministria e Zhvillimit Urban, duke u bazuar edhe në ecurinë e zbatimit dhe të realizimit të projekteve, programuar në buxhet me shtrirje në 2 apo 3 vite.



Tabela 1/2 Lista e disa projekteve, thirja e katërt për vitin 2016, me cikël zbatimi 2017-2018

Nr.	Autoriteti Kontraktues	Emërtimi i Projektit	Vlera e plotë e projektit (në Lekë)	Vlera e financimit për vitin 2017 (në Lekë)
QARKU BERAT				
1	Bashkia Kuçovë	Rikualifikimi urban i lagjes Nr.1, Blloku “11 Janari”, Kuçovë	147,336,682	44,201,005
QARKU DIBËR				
2	Bashkia Klos	Ndërtimi i Bypass-it të qytetit Klos	117,781,840	35,334,552
QARKU DURRËS				
3	Bashkia Durrës	Rikualifikimi i hapësirave midis Kuartallit nga Rruga “Skënderbej” deri në rrugën “Mars 91” e hapësira deri tek rruga e Portit, si dhe sistemimi i ujërave të bardha deri tek Ura e Dajlanit, Faza I	120,000,000	36,000,000
4	Bashkia Durrës	Rehabilitimi i Sheshit Publik pranë Mauzoleumit, Faza II	300,000,000	90,000,000
5	Bashkia Krujë	Zgjerimi i rrugës kryesore, si edhe rikualifikimi i sheshit Mustafa Merlika	112,984,822	33,895,447
QARKU TIRANË				
6	Bashkia Kavajë	Unaza lindore e Kavajës	164,256,191	49,276,857
QARKU ELBASAN				
7	Bashkia Librazhd	Rehabilitim urban i zonës në të dyja anët e rrugës kryesore, të qytetit Librazhd dhe sistem asfaltim, rruga e “Dibrës”	111,527,408	33,458,222
8	Bashkia Gramsh	Rehabilitimi i rrugës “Devoll”	76,274,846	22,882,454
QARKU VLORË				
9	Bashkia Vlorë	Rikualifikimi i bllokut të banesave kufizuar nga rrugët "Bulevardi Ismail Qemali", "Rruga Kosova", "Gjergj Araniti"	146,231,210	43,869,363
10	Bashkia Vlorë	Rikualifikimi i bllokut të banesave kufizuar nga rrugët "Bulevardi Ismail Qemali", "Rruga Hasan Kushta", "Gjergj Araniti"	169,814,508	50,944,352
QARKU KUKËS				
11	Bashkia Has	Rehabilitim i rrugës së fshatit Zahrisht	152,143,061	46,433,088
12	Bashkia Kukës	Sistemimi asfaltim i Unazës veriore të qytetit Kukës, karburanti i vjetër-stacioni Morinë	97,247,799	29,174,340
TOTALI			1,715,598,367	515,469,680



Shënim:

1. "Vlera e projektit", përfaqëson vlerën e financimit për projektin, miratuar me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.
2. "Vlera e financimit për vitin 2017" (tabela 1/2), është financimi me burim programin buxhetor "Infrastruktura vendore dhe rajonale", fondi për projekte të reja, nga buxheti 2017 i Ministrisë së Zhvillimit Urban. Vlera është komunikuar nga sekretariati teknik pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban, me shkresë nr.846, Prot.7.2.2017.
3. Likujidimi financiar për vlerën e projektit (ose për vlerën e kontratës pas prokurimit publik) në vitet në vazhdim do të kryhet nga Ministria e Zhvillimit Urban, duke u bazuar edhe në ecurinë e zbatimit dhe të realizimit të projekteve, programuar në buxhet me shtrirje në 2 apo 3 vite.

VENDIM

Nr. 30, datë 7.2.2017

**PËR VERIFIKIMIN E DEKLARIMEVE NË
FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË
FUNKSIONARIT PUBLIK, ANËTARË NË
KËSHILLIN E BASHKISË ELBASAN,
Z. GANI HIDA, NË ZBATIM TË LIGJIT
NR. 138/2015 "PËR GARANTIMIN E
INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË
ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE
USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE"**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 7.2.2017, me pjesëmarrjen e:

Denar	Biba	kryetar
Hysen	Osmanaj	zv.kryetar
Bledar	Skënderi	anëtar
Edlira	Jorgaqi	anëtare
Gëzim	Veleshnja	anëtar
Klement	Zguri	anëtar
Vera	Shtjefni	anëtare

Shqyrtoi çështjen me,

OBJEKT: Verifikimi i deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të funksionarit publikë anëtar në këshillin e Bashkisë Elbasan, z. Gani Hida, në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa "a", i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; neni 14, neni 15, i ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; kreu V, i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e

rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

KQZ-ja, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

VËREN:

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", KQZ-ja është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike, si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit edhe për këshilltarin në këshillin bashkiak.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe kreu V, pika 2, germa "b" dhe pikës 3, germa "c", të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", KQZ-ja, me shkresat nr. 2451 dhe 2452, datë 13.5.2016 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe zyra e gjendjes gjyqësore, për gjendjen gjyqësore të funksionarëve që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në KQZ.

Në përgjigje të shkresës, nga ana e zyrës së gjendjes gjyqësore është dërguar verifikim i gjendjes gjyqësore për të gjithë funksionarët publikë që kemi kërkuar. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ende nuk ka dërguar përgjigje për këshilltarët e këshillave bashkiake nëse kanë pasur ndryshime në gjeneralitetet e tyre.



Referuar nenit 33, 42 dhe 47 të Kodit të Procedurave Administrative, KQZ-ja thirri si palë në këtë shqyrtim administrativ, z. Gani Hida, ku dha shpjegimet për faktet dhe rrethanat e çështjes.

KQZ-ja, referuar nenit 15, pika 1, të ligjit 138/2015 dhe kreu VI, pika 6, kreu V, pika 3, germa “b” e vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, verifikoi nëse ndonjë nga rrethanat e paraqitura përfshihet brenda sferës së ndalimeve të parashikuara nga ligji për funksionarët e lartë përmendur.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Gani Hida, në cilësinë e anëtarit të këshillit të bashkisë Elbasan, rezulton se nuk ka dënim me vendim të formës së prerë nga autoritete gjyqësore shqiptare apo të huaja. Gjithashtu, në formularin e vetëdeklarimit nuk është paraqitur asnjë rast, ndalimi, hetimi, masë e sigurisë personale, dëbimi nga autoritetet, shqiptare apo të huaja.

Nga shqyrtimi i vërtetimit të gjendjes gjyqësore, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, rezulton se z. Gani Hida, është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë me 1 (një) vit burg, për kryerjen e veprave penale, “Shpërdorim i detyrës”, parashikuar nga neni 248, 48/ç dhe 49 i Kodit Penal, vendimi nr. 137, datë 18.2.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Referuar germës b, të pikës 1, të nenit 2, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ndalimet për kandidimin, zgjedhjen apo ushtrimin e funksionit zbatohen ndaj personave, të cilët janë dënuar me burgim me vendim të formës së prerë për kryerjen me dashje të një krimi... brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për kryerjen e veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë vepër penale, sipas neneve 110/c, 244, 245, 248, 248/a, 259, 260, 319, 319/ç, apo në fushën e zgjedhjeve, të parashikuar në kreun X “Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve”, të Kodit Penal.

Vepra penale “Shpërdorim i detyrës”, parashikuar nga neni 248, 48/ç dhe 49 i Kodit Penal, përfshihen, në fushën e ndalimit të ushtrimit të funksionit, të parashikuar në nenin 2, pika 1, germa “b” e ligjit nr.138/2015.

Ligji nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë

funksione publike”, në nenin 4 të tij, parashikon dhe periodhën gjatë të cilës zbatohen dispozitat e këtij ligji për ndalimin, kandidimin, zgjedhjen apo ushtrimin e funksionit, në varësi të llojit të veprës penale të deklaruar.

Sipas nenit 4 të ligjit të sipërcituar

1

2. Për personat që parashikohen nga shkronja “b”, e pikës 1, të nenit 2, të këtij ligji, ndalimi për kandidim, zgjedhje apo ushtrim të funksionit zgjat 20 vjet nga momenti i përfundimit të dënimit me burg, sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë.

Referuar vendimit nr. 137, datë 18.2.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan të formës së prerë në bazë të të cilit z. Hida është deklaruar fajtor për veprën penale “Shpërdorim i detyrës” dhe nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 138/2015, z. Hida është brenda periodhës për ndalimin e ushtrimit të funksionit.

Referuar të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të plotësuar nga z. Gani Hida, vërtetimit të gjendjes gjyqësore në lidhje me veprën penale , “Shpërdorim i detyrës”, parashikuar nga neni 248, 48/ç dhe 49, i Kodit Penal bazuar në germën “b”, pika 1, neni 2 i ligjit nr. 138/2015, funksionari publik, z. Gani Hida është në kushtet e ndalimit të ushtrimit të funksionit.

Neni 10, pika 1, e ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, parashikon se:

Kur verifikohen kushtet për moskandidim dhe moszgjedhje, në përputhje me këtë ligj, KQZ-ja kryen veprimet e mëposhtme:

.....

d) shpall pavlefshmërinë e mandatit dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit kur kushtet e pazgjidhshmërisë dhe moskandidimit verifikohen pas fillimit të ushtrimit të mandatit...., si dhe njofton Kryeministrin në rastin e kryetarit të bashkisë apo të këshilltarit bashkiak.

Për sa më sipër, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, referuar nenit 179/1 të Kushtetutës, nenit 14 dhe nenit 10, pika 1, germa “d”, shpall pavlefshmërinë e mandatit dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të funksionarit publik, z. Gani Hida.



PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 179/1 të Kushtetutës, në nenin 23, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; nenin 14, nenin 15, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; kreun V, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

VENDOSI:

1. Të shpallë të pavlefshëm dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të anëtarit të këshillit të Bashkisë Elbasan, z. Gani Demir Hida.
2. Ky vendim t’i njoftohet menjëherë Kryeministrit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim sipas ligjit.

KRYETAR
Denar Biba

VENDIM
Nr. 35, datë 7.2.2017

**PËR VERIFIKIMIN E DEKLARIMEVE NË
FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË
FUNKSIONARIT PUBLIK, ANËTARË NË
KËSHILLIN E BASHKISË MALIQ, Z.
TOMOR PRENJASI, NË ZBATIM TË
LIGJIT NR. 138/2015 “PËR
GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË
PERSONAVE QË ZGJIDHEN,
EMËROHEN OSE USHTROJNË
FUNKSIONE PUBLIKE”**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 7.2.2017, me pjesëmarrjen e:

Denar	Biba	kryetar
Hysen	Osmanaj	zv.kryetar
Bledar	Skënderi	anëtar
Edlira	Jorgaqi	anëtare
Gëzim	Veleshnja	anëtar
Klement	Zguri	anëtar
Vera	Shtjefni	anëtare

Shqyrtoi çështjen me,

OBJEKT: Verifikimi i deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të funksionarit publikë anëtar në këshillin e Bashkisë Maliq, z. Tomor Prenjasi, në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa “a”, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; neni 15, i ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; kreu V, i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

KQZ-ja, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

VËREN:

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, KQZ-ja është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike, si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit edhe për këshilltarin në këshillin bashkiak.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe kreu V, pika 2, germa “b” dhe pikës 3, germa “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, KQZ-ja, me shkresat nr. 2451 dhe 2452, datë 13.5.2016 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe zyra e gjendjes gjyqësore, për gjendjen gjyqësore të funksionarëve që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në KQZ.

Në përgjigje të shkresës, nga ana e zyrës së gjendjes gjyqësore është dërguar verifikim i gjendjes gjyqësore për të gjithë funksionarët publikë që kemi kërkuar. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ende nuk ka dërguar përgjigje për këshilltarët e këshillave bashkiake nëse kanë pasur ndryshime në gjeneralitetet e tyre.



Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë, sektori i dekriminalizimit në Prokurorinë e Përgjithshme, me shkresën nr. 2700, datë 20.6.2016 i ka kërkuar KQZ-së verifikimin e të dhënave të deklaruar në formularin e vetëdeklarimit të z. Tomor Prenjasi.

Referuar neneve 33, 42 dhe 47 të Kodit të Procedurave Administrative, KQZ-ja thirri si palë në këtë shqyrtim administrativ, z. Tomor Prenjasi, ku dha shpjegimet për faktet dhe rrethanat e çështjes.

KQZ-ja, referuar nenit 15, pika 1 të ligjit 138/2015 dhe kreut VI, pika 6, kreut V, pika 3, germa “b” të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, verifikoi nëse ndonjë nga rrethanat e paraqitura përfshihet brenda sferës së ndalimeve të parashikuara nga ligji për funksionarët e lartë përmendur.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Tomor Prenjasi, në cilësinë e anëtarit të këshillit të bashkisë Maliq, rezulton se nuk ka dënim me vendim të formës së prerë nga autoritete gjyqësore shqiptare apo të huaja.

Gjithashtu në formularin e vetëdeklarimit nuk është paraqitur asnjë rast, ndalimi, hetimi, masë e sigurisë personale, dëbimi nga autoritetet, shqiptare apo të huaja.

Nga shqyrtimi i vërtetimit të gjendjes gjyqësore, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, rezulton se z. Tomor Prenjasi, është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë me 3 (tre) muaj burg, vendimi nr. 75, datë 27.3.1989 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë për kryerjen e veprave penale, “Dëmtimi me dashje i pasurisë socialiste”, parashikuar nga neni 67/1 dhe 30/dh i Kodit Penal, të para vitit 1995, parashikuar nga kreu III, seksioni III i Kodit Penal në fuqi.

Është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë me 10 (dhjetë) muaj burg, vendimi nr. 213, datë 24.8.1989 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë për kryerjen e veprave penale, “Plagosje e lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 93/1 dhe 31/a i Kodit Penal, të para vitit 1995, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal në fuqi.

Është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë me 1 (vit) burg, vendimi nr. 275, datë 28.10.1989 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë për kryerjen e veprave penale, “Sjellje e padenjë

në shoqëri”, parashikuar nga neni 129/1 dhe 31/a i Kodit Penal, të para vitit 1995, parashikuar nga kreu II, seksioni VIII i Kodit Penal në fuqi.

Referuar germës “ç”, të pikës 1 të nenit 2, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ndalimet për kandidimin, zgjedhjen apo ushtrimin e funksionit zbatohen ndaj personave të cilët janë dënuar me burgim me vendim të formës së prerë për kryerjen me dashje të një krimi... kur janë dënuar me jo më pak se 6 muaj burgim.

Ligji nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, në nenin 4 të tij, parashikon dhe periudhën gjatë të cilës zbatohen dispozitat e këtij ligji për ndalimin, kandidimin, zgjedhjen apo ushtrimin e funksionit, në varësi të llojit të veprës penale të deklaruar.

Sipas nenit 4 të ligjit të sipërcituar

.....

4. Për personat që parashikohen nga shkronja “ç”, e pikës 1, të nenit 2, të këtij ligji, ndalimi zgjat nga momenti i përfundimit të dënimit me burg, sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë, deri në momentin e rehabilitimit, sipas nenit 69 të Kodit Penal.

Referuar të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të plotësuar nga z. Tomor Prenjasi, vërtetimit të gjendjes gjyqësore në lidhje me veprën penale, “Plagosje e lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 93/1 dhe 31/a i Kodit Penal, të para vitit 1995, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal në fuqi dhe për veprave penale, “Sjellje e padenjë në shoqëri”, parashikuar nga neni 129/1 dhe 31/a i Kodit Penal, të para vitit 1995, parashikuar nga kreu II, seksioni VIII i Kodit Penal në fuqi, për këto vepra penale, funksionari publik nuk është rehabilituar, si pasojë është brenda periudhës së ndalimit për ushtrimin e funksionit. Bazuar në germën “ç”, pika 1, neni 2, i ligjit nr. 138/2015, funksionari publik z. Tomor Prenjasi është në kushtet e ndalimit të ushtrimit të funksionit.

Neni 10, pika 1, e ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, parashikon se:



Kur verifikohen kushtet për moskandidim dhe moszgjidhje, në përputhje me këtë ligj, KQZ-ja kryen veprimet e mëposhtme:

.....

d) shpall pavlefshmërinë e mandatit dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit kur kushtet e pazgjidhshmërisë dhe moskandidimit verifikohen pas fillimit të ushtrimit të mandatit..., si dhe njofton Kryeministrin në rastin e kryetarit të bashkisë apo të këshilltarit bashkiak.

Në këto kushte, KQZ-ja duhet të shpallë të pavlefshëm dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të funksionarit publik z. Tomor Prenjasi.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, germa a, i Ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; nenin 15, i ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritet të

personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; kreu V, i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritet të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

VENDOSI:

1. Të shpallë të pavlefshëm dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të anëtarit të këshillit të Bashkisë Maliq, z. Tomor Ramadan Prenjasi.

2. Ky vendim t’i njoftohet menjëherë Kryeministrit.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim sipas ligjit.

**KRYETAR
Denar Biba**

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 168 lekë